

UDHËZIM
Nr.3, datë 26.2.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 30.1.2006 TË
MINISTRIT TË FINANCAVE "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në përmbajtjen e udhëzimit nr.3, datë 30.1.2006 të Ministrit të Financave, në pikën 16.1 "Rimbursimi i eksportuesve", bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

- Në përmbajtjen e paragrafit të parë, nënparagrafët e dytë, të tretë dhe të katërt shfuqizohen.
- Në përmbajtjen e paragrafit të parë, mbas nënparagrafit të parë, shtohet një nënparagraf me përmbajtjen si vijon:

"Teprica kreditore, që kërkohet si e rimbursueshme, duhet të jetë më shumë se 400.000 lekë."

- Paragrafi i dytë shfuqizohet.

- Mbas paragrafit të pestë, shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Eksportuesve me risk zero, për shumat deri në 400.000 lekë, rimbursimi u bëhet në mënyrë automatike, me paraqitjen e kërkesës në degën e tatimeve.

Për kategoritë e tjera, rimbursimi i eksportuesve bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tyre."

- 2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode